

VENDIM
Nr.73, datë 4.2.2005

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË DELVINËS SË MJEDISEVE TË
ISH-BRIGADËS SË KËMBËSORISË, NË RUSAN, DELVINË, TË CILAT JANË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-brigadës së këmbësorisë, në Rusan, Delvinë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Delvinës, për t’u përdorur për nevoja strehimi për popullsinë e kësaj bashkie.

2. Prona me numër rendor 638, “ish-brigadë këmbësorie”, në Rusan, Delvinë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Delvinës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia e Delvinës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano